

VENDIM
Nr.897, datë 10.11.2010

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.954, DATË 30.9.2009 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR ORGANIZIMIN, STRUKTURËN, FUNKSIONIMIN E QENDRËS
NDËRINSTITUCIONALE OPERACIONALE DETARE (QNOD) DHE BASHKËVEPRIMIN
ME INSTITUCIONET SHTETËRORE, QË KANË INTERESA NË DET”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 32 të ligjit nr.9251, datë 8.7.2004 “Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë”, të neneve 3, pika 3 e 4/1, pika 3 e ligjit nr.8875, datë 4.4.2002 “Për Rojën Bregdetare Shqiptare”, të ndryshuar, dhe të neneve 6, 29 e 41 të ligjit nr.9861, datë 24.1.2008 “Për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit shtetëror”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.954, datë 30.9.2009 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

a) Në paragrafin e parë të pikës 7 të kreut III, fjalët “... i cili caktohet nga Ministri i Mbrojtjes ...” zëvendësohen me “... i cili caktohet nga Kryeministri, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes ...”.

b) Pika 1 e kreut IV, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Veprimtaria operationale e Qendrës Ndërinstitucionale Operacionale Detare përcaktohet në dokumentin “Politikat dhe procedurat e funksionimit të Qendrës Ndërinstitucionale Operacionale Detare”, i cili miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

c) Pika 2 e kreut VI shfuqizohet.

2. Ngarkohet Ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha